



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2023:258774
Datë: 28.12.2023
Numri i dokumentit: 05137210

PPP. nr. 81/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Astrit Gashi me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Remzi Duli, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit G.H nga Komuna Gllogocit të cilin e përfaqëson B.Ç nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Gllogocit-Drejtoria e Arsimit, lidhur me borxhin në shumën prej 1,514.00 €, duke vendosur në prapësimin e ushtruar nga debitori kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit të Përmbartuesit G.M në shenjë P.nr... të datës 20.10.2023, jashtë seancës me datë 28.12.2023 e mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET prapësimi i debitorit Komuna e Gllogocit-Drejtoria e Arsimit kundër urdhërit të Përmbartuesit Privat G.M nën shenjë P. nr... të datës 20.10.2023, me të cilin është lejuar propozimi i kreditorit G.H nga Komuna e Gllogocit për përmbartimin e borxhit në shumën prej 1,514.00 € në bazë të dokumentit të përmbartueshëm, ndërsa urdhëri i Përmbartuesit Privat P. Nr... i datës 20.10.2023 **mbetet në fuqi**.

A r s y e t i m

I autorizuari i Kreditorit ka parashtruar propozim të Përmbartuesi Privat G.M nga Ferizaj për lejimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të përmbartueshëm të Aktgjykimit C.nr.324/20 e datës 14.12.2021 lidhur me pagesën e borxhit-kamatën ligjore siç është cekur në dispozitiv të Aktgjykimit C.nr.324/20 në lartësi prej 1,514.00 €, me kamatë vjetore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat 7 ditor në të kundërtën, të bllokohen llogaritë bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjete në llogari të bëhet regjistrimi, sekuestrimi, vlerësimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme e mjetet e mbledhura të derdhen në llogari të kreditorit.

Përmbartuesi Privat G.M duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Aktgjykimit C.nr.324/20 e datës 14.12.2021.

Debitori ka paraqitur prapësim kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit në afatin ligjor me arsyetimin se: *fillimisht pala kreditore shumë e kërkuar ka mundur ta realizoj përmes propozimit për përmbarim të dorëzuar pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Dega në Gllogoc e cila e mbanë shenjën CP.nr.124/2022 në të cilin propozim përveç borxhit kryesor pala kreditore ka kërkuar edhe kamatën prej 8%. Po ashtu theksojnë se nuk janë të obliguar të paguajnë kamatën pasi që është një lëshim i kreditorës me rastin e paraqitjes se propozimit për përmbarim të mëparshëm, andaj ka kërkuar që në vështrim të Nenit 73 par. 3 të LPP-së të aprovohet si i bazuar prapësimi i tij dhe të refuzohet si i pa bazuar urdhëri për përmbarim i përmbaruesit privat.*

Kreditore në afatin ligjor ka paraqitur përgjigjeje në prapësim duke kundërshtuar prapësimin e debitorit në tërësi si të pa bazuar dhe të pa argumentuar me asnjë provë, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhëri P.nr... i datës 20.10.2023 të mbetet në fuqi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është pa i bazuar, ndërsa kundërshtimet e prapësimit të dhëna nga kreditore në përgjigje në prapësim, gjykata i konsideroi si të qëndrueshme dhe atë për këto arsye.

Me shikimin e shkresave të lëndës gjykata e vërtetoi faktin se kreditore propozimin për përmbarim e ka bërë për përmbarimin e dokumentit të përmbarueshëm të Aktgjykimit C.nr 324/20 i datës 14.12.2023 të lartëcekur për shkak të detyrimit në të holla si më lartë, i cili propozim është lejuar me urdhërin e Përmbaruesit Privat e me propozimin e mjeteve gjegjëse të përmbarimit të parapara me dispozitat ligjore të LPP-së për realizimin e detyrimit në të holla që rrjedh nga Aktgjykimi si në rastin konkret.

Lidhur me atë se me çfarë baze juridike caktohet përmbarimi, se çka përmbaruesi i dokumentit i përmbarimit, se çka duhet të përmbarë një propozim për përmbarim të dokumentit të besueshëm, si dhe kushtet ligjore për caktimin e përmbarimit janë të përcaktuara me dispozitat ligjore të nenit 21, 22, 29, 30, 37, 38 dhe 40 të LPP-së, ndërsa shkaqet e prapësimit janë përcaktuar në Nenin 71 të LPP-së, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentet e besueshme nga të cilat shihet se debitori i ka borxhin në fjalë kreditorit.

Debitori në prapësimin e tij ka pretenduar se nuk ka obligim ndaj kreditorës gjykata nuk e aprovoj këtë pretendim e debitorit pasi që nuk ka bazë ligjore lidhur me pretendimet të paraqitura në prapësim, ndërsa kreditore në anën tjetër propozimit për përmbarim i ka bashkangjitur Aktgjykimin C.nr.324/20 i datës 14.12.2021 i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm i lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc, i cili i plotëson kushtet ligjore për të u trajtuar si dokument i përmbarueshëm në kuptim të Nenit 22 par. 1.1 të LPP-së.

Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e refuzuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi urdhërin përmbarues për caktimin e përmbarimit P. nr... të datës 20.10.2023, duke u bazuar në Nenin 73 par. 3 të LPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Gllogoc
Departamenti i Përgjithshëm, PPP. nr. 81/23, datë 28.12.2023**

Numri i lëndës: 2023:258774
Datë: 28.12.2023
Numri i dokumentit: 05137210

Gjyqtari
Astrit Gashi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.